



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 156

**Tiranë – E mërkurë, 17 gusht 2016**

## PËRMBAJTJA

|                                                                   | Faqe                                                                                                                                                                                                                                   |
|-------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Dekret i Presidentit<br>nr. 9716, datë 2.8.2016                   | Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Dibër, qarku Dibër..... 11939                                                                                                                                               |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 9719, datë 8.8.2016                   | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11939                                                                                                                                                                                          |
| Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 393, datë 5.8.2016 | Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e parakohshme për kryetar të Bashkisë Dibër, qarku Dibër..... 11939                                                                                                   |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese<br>nr. 58, datë 4.8.2016            | Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 38, datë 18.6.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-2808, datë 5.11.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 11941 |

**DEKRET****Nr. 9716, datë 2.8.2016**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË  
ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR  
TË BASHKISË DIBËR,  
QARKU DIBËR**

Në mbështetje të nenit 92, germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Caktimin e datës 11 shtator 2016, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Dibër, qarku Dibër.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**DEKRET****Nr. 9719, datë 8.8.2016**

**PËR DHËNIE TË SHKETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Giovanni Salvatore Peragine
2. Fazli Tahir Tahiri
3. Veli Abdullah Idi
4. Cüneyt Altan Atila Erigüç
5. İsmet Adem Tunç
6. Halime Tuba Resul Shuaipi (Koyuncu)
7. Eyüp Yılmaz Şalambar

8. Olsi Pellump Selimollari

9. Ömer Refik Kaleli

10. Adnan Eşref Şenkardes

11. Shukri Sefer Jahiu

12. Flamur Sulejman Lokaj

13. Ahmed Abdelfattah Abdelhamid Morsy (Morsi) Elmaghraby

14. Miftar Dan Krasniqi

15. Rita Vasim Koci (Gazieva/Merzlyakova)

16. Gülşah Nedim Rryta (Arici)

17. Hossam Ibrahim Hassanein Ibrahim

18. Arif Muharrem Ince

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**UDHËZIM****Nr. 393, datë 5.8.2016**

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË  
LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR  
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR  
KRYETAR TË BASHKISË DIBËR,  
QARKU DIBËR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 59, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të dekretit nr. 9716, datë 2.8.2016 të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Dibër, qarku Dibër,

**UDHËZOJ:**

1. Lista e zgjedhësve gjenerohet automatikisht nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, sipas afateve që parashikon ligji dhe është e vlefshme për t'u shkarkuar *on-line* nga aplikacioni përkatës i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Procedura e gjenerimit të listës së zgjedhësve është funksionalitet i sistemit, Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, ku përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në njësinë administrative shkarkon nga ky sistem përbërësit zgjedhorë, për zgjedhësit, sipas vendbanimit përkatës, si më poshtë:



- përzgjedh në menunë në të majtë të faqes së RKGJC-së, opsionin “Procesi i regjistrimit”, “Raportime” dhe zgjedh listën.

2. Nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile gjenerohet formati elektronik i përbërësve zgjedhore, brenda datës 7.8.2016, i ndarë sipas qendrave të votimit të zgjedhjeve, të datës 21.6.2015, për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore.

3. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në njësinë administrative kontrollon raportin ditor, për numrin e zgjedhësve për çdo qendër votim. Kur vëren në raportin ditor, se ka qendra votimi me më pak se 200 zgjedhës apo qendra votimi me më shumë se 1000 zgjedhës, njofton brenda datës 6.8.2016, kryetarin në detyrë të bashkisë. Këto lista gjenden në formatin e posaçëm dhe kanë të shkruar në sfond “Jo për afishim” e mund të përdoren vetëm për ndarjen apo bashkimin e qendrave të votimit sipas ligjit, por në asnjë rast nuk mund të përdoren për afishim apo në faza të tjera të procesit zgjedhor. Gjithashtu, në format të posaçëm, është edhe lista e zgjedhësve mbi 100 vjeç në datën e zgjedhjeve. Kjo listë i njoftohet kryetarit në detyrë të bashkisë, për të bërë njoftimin për arsyen e mospasqyrimin në listën e zgjedhësve të këtyre shtetasve. Në format të posaçëm është edhe lista e zgjedhësve që e kanë numrin e qendrës së votimit të ndryshëm nga qendra e votimit që i përkasin kësaj zyre të gjendjes civile.

4. Lista e zgjedhësve është e grupuar sipas zonave të qendrave të votimit. Kufijtë e zonave të qendrave të votimit janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetari në detyrë i bashkisë, i cili ka marrë njoftimin nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, vendos brenda datës 6.8.2016 bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit, sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit.

5. Në rastet e qendrave të votimit me fraksion, të cilat kalojnë limitin numerik të përcaktuar në ligj, kryetari në detyrë vendos ndarjen e tyre, duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë dhe jo çdo fraksion veç e veç. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi, me gjithë fraksionet e saj, do të ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se 1000 zgjedhës secila.

6. Për qendrat e votimit me më pak se 200 zgjedhës, kryetari në detyrë vendos bashkimin e kësaj qendre me një qendër më të afërt dhe me

mundësi komunikimi rrugor, shuma e numrit të zgjedhësve, të të cilave duhet të jetë më shumë se 200 zgjedhës. Nëse shuma e numrit të zgjedhësve për qendrat që do të bashkohen është më shumë se 1000 zgjedhës, atëherë, kryetari në detyrë pas bashkimit të këtyre qendrave vendos ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, sipas pikës 5 të këtij udhëzimi. Nëse dy a më shumë qendra votimi kanë më pak se 200 zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël zgjedhësish i bashkohen qendrës me numër më të madh zgjedhësish.

7. Vendimet e kryetarit në detyrë për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit, nëse ka të tilla, do t'i dërgohen në formë shkresore për zbatim zyrës së gjendjes civile përkatëse, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe për dijeni Prefektit të Qarkut Dibër, jo më vonë se data 6.8.2016.

8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në njësinë administrative me marrjen e vendimit të kryetarit në detyrë, për ndarjen e qendrave të votimit brenda datës 7.8.2016, kryen veprimet e mëposhtme:

a) Në menunë majtas zgjedh “Administrimi i qendrave të votimit”;

b) Zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të ndahet;

c) Plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “sipas vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2015 të kryetarit”;

d) Shtyp butonin “Ruaj”.

Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast të mosrealizimit të ndryshimeve, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile ekzekuton automatikisht kërkesën për ndarjen e qendrës së votimit, sipas kriterit numerik dhe mbiemrit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës së votimit bazë. Në rast se kryetari ka vendosur që adresa e qendrës së votimit me fraksion është e ndryshme nga adresa e qendrës së votimit bazë, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile korrigjon adresën e qendrës së votimit me fraksion.

9. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile me marrjen e vendimit të kryetarit në detyrë për bashkimin e dy a më shumë qendrave të votimit, brenda datës 7.8.2016 kryen veprimet, si më poshtë:



a) Në menunë majtas zgjedh “Administrimi i qendrave të votimit”;

b) Zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të mbyllet, si dhe numrin e qendrës së votimit pritëse;

c) Plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “sipas vendimit nr. \_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/2015 të kryetarit;

d) Shtyp butonin “Ruaj”.

Ky informacion mund të ndryshohet deri në 24:00 të së njëjtës ditë. Në rast të mosrealizimit të ndryshimeve, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile ekzekuton automatikisht kërkesën për bashkimin e qendrave të votimit sipas vendimit të kryetarit.

10. Procedura e përshkruar në pikat 4, 5, 6 dhe 7 do të zbatohet nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe nga kryetari në detyrë.

11. Në rast se kryetari në detyrë nuk përmbush detyrimet sipas pikës 4, 5, 6 dhe 7 të këtij udhëzimi, deri në publikimin e listës së zgjedhësve, DPGJC-ja kryen menjëherë ndarjen dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, të cilat reflektohen në listat e zgjedhësve të datës 21.6.2015.

12. Zyrat e Gjendjes Civile në bashki, në datën 7.8.2016, printojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile dhe firmosin e vulosin listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, në tri formatet e parashikuara nga Kodi Zgjedhor, duke përfshirë edhe institucionet e posaçme nën juridiksionin territorial të saj dhe ia dorëzojnë kryetarit në detyrë.

13. Kryetari në detyrë miraton, firmos listën dhe e dërgon brenda datës 9.8.2016 në të tri formatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, në KZAZ-në përkatëse.

14. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon listën Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

15. Zgjedhësit, të cilët pas shpalljes së listës së zgjedhësve konstatojnë se në përbërësit e tyre zgjedhorë ka mospërputhje ose nuk janë të përfshirë në listën e zgjedhësve, i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës.

16. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, jo më vonë se data 17.8.2016, i dërgon një kopje të listës së zgjedhësve Arkivit Qendror të Shtetit.

17. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet kryetari në detyrë i Bashkisë Dibër, Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, përgjegjësit e zyrave të gjendjes civile në Bashkinë Dibër, si dhe

institucionet e tjera shtetërore që parashikohen në Kodin Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE  
TË BRENDSHME  
Stefan Çipa

## VENDIM Nr. 58, datë 4.8.2016

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| Bashkim Dedja   | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Sokol Berberi   | anëtar i “ “                   |
| Vitore Tusha    | anëtare e “ “                  |
| Altina Xhoxhaj  | anëtare e “ “                  |
| Fatmir Hoxha    | anëtar i “ “                   |
| Besnik Imeraj   | anëtar i “ “                   |
| Vladimir Kristo | anëtar i “ “                   |

me sekretare Edmira Babaj, në datën 19.7.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 42 akti, që i përket:

KËRKUES: Klajdi Bitri

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 38, datë 18.6.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-2808, datë 5.11.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



## VËREN:

## I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 83, datë 8.3.2006, ndër të tjera, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit Klajdi Bitri për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendimin, në bashkëpunim, dhe në bazë të neneve 78/1 dhe 25 të Kodit Penal (KP) dënimin e tij me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Klajdi Bitri për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake që ka sjellë pasoja të rënda dhe në bazë të nenit 278/4 të KP-së dënimin e tij me 6 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së dënimin e tij përfundimisht me 25 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 246, datë 2.6.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 83, datë 8.3.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 47, datë 30.1.2008 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me trup tjetër gjyqësor.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 14, datë 18.6.2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 83, datë 8.3.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për kërkuesin dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të tij.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 325, datë 4.12.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 14, datë 18.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me trup gjyqësor, me arsyetimin se duhet *“të analizohet e të arrihet në një përfundim të qartë logjiko-juridik nëse konkluzionet shkencore të arritura me eksperimentin hetimor përputhen me rrethanat e faktit penal të dala nga këqyrja e vendit të ngjarjes, thëniet e dëshmitarëve e shpjegimet e të gjykuarve”*.

6. Gjykata e Apelit Vlorë, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 38, datë 18.6.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 83, datë 8.3.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me ndryshimin e vetëm që për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278/2 të KP-së, ka përcaktuar dënimin e tij me 3 vjet burgim.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2808, datë 5.11.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga i gjykuari Klajdi Bitri, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

## II

8. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese. Ai pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

8.1 Gjykata e Apelit Vlorë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e mbrojtjes, pasi nuk ka lejuar pjesëmarrjen e tij në proces. Gjykata e Lartë nuk e ka korrigjuar këtë shkelje.

8.2 Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nuk është i arsyetuar në pajtim me dispozitën kushtetuese, me jurisprudencën e Gjykatës, si dhe me *case law* të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

8.3 Është cenuar parimi i barazisë së armëve, sepse Gjykata e Apelit Vlorë e ka vendosur të pandehurin në një pozitë të disfavorshme në raport me palën tjetër.

8.4 Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë.

9. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar me shkrim si më poshtë:

9.1 Nuk është cenuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim, sepse kërkuesi me vullnetin e tij nuk është paraqitur në gjykim, ndërsa e drejta e mbrojtjes efektivisht është realizuar nga avokati i tij.

9.2 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë nuk është i bazuar, sepse shkaqet e paraqitura në rekurs janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, dhe ajo u ka dhënë përgjigje lidhur me to.

9.3 Vendimi i Gjykatës së Apelit është bazuar në një vlerësim të plotë të rrethanave të faktit, të provave të shqyrtuara dhe të administruara në gjykim, si dhe në mënyrën e vlerësimit të tyre, duke pasqyruar me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat gjykata mbështet vendimin e shkallës së parë.



9.4 Argumentet mbi të cilat kërkuesi mbështet pretendimin për cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga ana e gjykatës për të krijuar bindjen e brendshme në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e tij.

9.5 Kërkuesi nuk ka parashtruar me argumente bindëse pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

### III

#### A. Në lidhje me formimin e trupit gjykues

10. Gjyqtarët Gani Dizdari dhe Fatos Lulo, në mbështetje të nenit 36, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kanë kërkuar dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, me argumentin se ata kanë marrë pjesë në gjykimin e së njëjtës çështje në Gjykatën e Lartë. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e ka vlerësuar si të bazuar kërkesën dhe ka vendosur pranimin e saj në përputhje me nenin 36, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për këto arsye çështja është gjykuar nga një trupë e përbërë nga shtatë gjyqtarë.

### IV

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### B. Për legjitimitimin e kërkuetit

11. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesi, *prima facie*, legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij hyjnë në juridiksionin kushtetues.

##### C. Për themelin e kërkesës

12. Kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, e drejta e mbrojtjes, standardi i arsytimit të vendimit, parimi i barazisë së armëve, si dhe parimi i prezumimit të pafajësisë.

13. Gjykata, pasi mori në shqyrtim pretendimet e kërkuetit, gjatë votimit në lidhje me to nuk arriti shumicën e votave të të gjithë anëtarëve për asnjërën prej tyre<sup>1</sup>. Në kushtet kur nuk plotësohen kriteret e nenit 73/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe kur asnjë përfundim i çështjes nuk u votua nga shumica e kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit organik, arrin në përfundimin se kërkesa duhet të refuzohet.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f, 134/1/g dhe 133/2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

#### VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj

<sup>1</sup> Votuan për pranimin pjesërisht të kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vladimir Kristo dhe Besnik Imeraj. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj dhe Fatmir Hoxha.

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë